



Prishtinë, 24 shtator 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1030_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve;
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Lagjja Marigona Residence, ZK Preoci, me kapacitet të instaluar prej 100 kW në Komunën e Graçanicës, të datës 05.09.2018 me nr. prot. 399/2018 të “Çarshia” SH.P.K., me adresë: Lagjja Marigona Residence Nr. 7/1, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 24 shtator 2018 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa “Çarshia” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Lagjja Marigona Residence, me kapacitet të instaluar prej **100 kW**, në ngastrën kadastrave Nr. 602/76 ZK Preoci, Komuna e Graçanicës.
- II. **OBLIGOHET** - “Çarshia” SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR-90109825, që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum, të parashtoj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas përqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. “Çarshia” SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vet-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

A r s y e t i m





- ZRRE, me datë 05.09.2018 nga “Çarshia” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Lagjja Marigona Residence, me kapacitet të instaluar prej **100 kW**, në ngastrat kadastrave Nr. 602/76 ZK Preoci, Komuna e Graçanicës.
 - “Çarshia” SH.P.K., s’bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik nr. 8351 të datës 13.08.2018 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Graçanicës.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së “Çarshia” SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum nga panelet solare/fotovoltaike në Lokacionin Lagjja Marigona Residence, me kapacitet të instaluar prej **100 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vet-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.





Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Graçanicës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.